

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 55, paragrafi (1) nga Ligji në fjalë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 të datës 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programre nr.ark.10-1865/1 të datës 23.4.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2063/7 të datës 12.5.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele gjatë seancës së 17-të të mbajtur më 12.05.2026, miratoi:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i parë programor (RTM1), për shkeljen e kryer të nenit 55, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më datë 23, 25, 27 dhe 29 mars dhe më 8, 10 dhe 12 prill 2026, në edicionet premierë dhe reprizat e programit për fëmijë „Mužicka fabrika“ (fabrika muzikore), ka shfrytëzuar kuminikim komercial audiovizual „plasim të produkteve“, e cila nuk lejohet në programet për fëmijë.

Shkelja e paragrafit (1) të kësaj pike, është specifikura në Raportin me shkrim të mbikëqyrjes së kryer programore nr.ark.10-1865/1 të datës 23.4.2026, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që Ndërmarrja publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i parë programor (RTM1), në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV-së.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendim, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij neni, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 55, paragrafi (1) të LSHMA-së, plasim i produkteve lejohet në të gjitha llojet e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, me përjashtim të lajmeve dhe programeve kushtuar çështjeve dhe temave aktuale, programeve kushtuar çështjeve lidhur me konsumatorët, programeve fetare dhe programeve për fëmijë.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 23 prill 2026, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim) mbi shërbimin programor televiziv të Ndërmarrjes publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimii parë programor (RTM1), në periudhën nga data 23 deri më 29 mars dhe nga data 6 deri më 12 prill 2026, në nivel shtetëror gjatë së cilës është konstatuar shkelja e nenit 55, paragrafi (1) të LSHMAAV.

Përkatesisht, nga mbikëqyrja u konstatua se më datë 23, 25, 27 dhe 29 mars dhe më 8, 10 dhe 12 prill 2026, Ndërmarrja publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i parë programor (RTM1), në datat e treguara në mars dhe prill 2026, në periudhën kohore të paraqitura në tabelën e cituar të Raportit me shkrim, RTM1 ka transmetuar edicione premierë dhe repriza në programin për fëmijë - „Muzička fabrika“(fabrika muzikore), klasifikuar si – shou-muzikor real për përzgjedhjen e fëmijë më të talentuar për këngë, në të cilin në kundërshtim të nenit 55, paragrafi (1) të LSHMAAV është shfrytëzuar komunikim komercial audiovizual „plasim i produkteve“, shfrytëzimi i të cilit nuk lejohet në programet për fëmijë. Në transmetimin e programit për fëmijë „Muzička fabrika“(fabrika muzikore) u përfshinë produkte, shërbime dhe shenja mbrojtëse të: - „Pelisterka“ (shishe me ujë); - „Vitaminka“ (smoki / çoko-flipsa); - „Taze“ (kokoshka dhe shenja mbrojtëse (marka tregtare) e firmës, të shtypura në varset e kartave identifikuese të pjesëmarrësve); - „EAM“ (pulovrave); si dhe shenjat mbrojtëse të firmave - „Triglav“ dhe „Halkbank“, të shtypura në dritat ambientale që janë pjesë e skenografisë së emisionit, në varësen e kartave të identifikimit të pjesëmarrësve. Siç shpjegohet në pikën 7 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve – ku „programe për fëmijë janë lloje të programeve me funksion informues, edukativ dhe argëtues, në veprimin e të cilit marrin pjesë fëmijët dhe/ose veprimi është i destinuar për fëmijë deri në moshën 12 vjeçare“.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1865/1 të datës 23.4.2026, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV-së, Këshilli i Agjencisë drejtuar Ndërmarrjes publike radiodifuzive (NDP) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i parë programor (RTM1) më 27.4.2026, i dërgoi Shkresë nr.ark.10-1865/2 datë 27.4.2026, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1865/1 të datës 23.4.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 27.4.2026. Në afatin e parashikuar, Ndërmarrja publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë gjatë seancës së mbajtur më 12.5.2026, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që Ndërmarrjes publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i parë programor (RTM1) t'i shqiptojë masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 55, paragrafi (1) nga Ligji në fjalë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1865/1 të datës 23.4.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2063/7 të datës 12.5.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë gjatë seancës së mbajtur më 12.5.2026, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron Ndërmarrjen publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i parë programor (RTM1) dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e

LSHMAAV-së. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV-së, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetent. Padinë për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1865/1 të datës 23.4.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani